

VENDIM
Nr.589, datë 5.9.2007

PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME
SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme ruan dhe siguron, me punonjës të Policisë së Shtetit, objektet shtetërore, të përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Fondi i pagave dhe i shpenzimeve, të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, të mbulohet nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Brendshme.
 3. Objektet, të cilat nuk përfshihen në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që, aktualisht, janë në ruajtje nga Policia e Shtetit, brenda 2 muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të merren në ruajtje nga vetë subjektet.
 4. Vendimet nr.112, datë 8.3.2001 “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore”, të ndryshuar, dhe nr.390, datë 15.8.2002 “Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore”, të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.
 5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja 1

LISTA E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE QË DO TË RUHEN
NGA POLICIA E SHTETIT

Policia e Shtetit do të ruajë dhe sigurojë objektet e mëposhtme:

1. Selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore.
2. Godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Ushtarake dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
3. Godina e Gjykatës Kushtetuese.
4. Godina e Gjykatës së Lartë.
5. Godina e Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës Ushtarake të Apelit.
6. Godina e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda.
7. Godinat e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.
8. Banka e Shqipërisë e filialet e saj, si objekti “X-79” e “X-88”, Tiranë dhe shoqërimi i vlerave monetare në lëvizje.
9. Godina e Arkivit Qendror Shtetëror.
10. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin dhe Pastrimin e Parave, në Ministrinë e Financave.